



FLEANCI GORENCA

Nga një ëndërr për laboratorin tek realiteti

Çmontonte paisje, analizonte qarqe, e imagjinonte veten një ditë në laboratorët e kompanive të mëdha teknologjike. Por realiteti shqiptar e përplasi me një fakt të thjeshtë: industria e elektronikës në vend është e kufizuar dhe mundësitë janë të pakta. *“Ëndrra ime ishte të punoja në një laborator kërkimor. Gjatë këshillimit të karrierës, e kuptova se kjo është shumë e vështirë të realizohet në Shqipëri,”* rrëfen ai. Ishte përballja e parë me kufijtë që i vendos realiteti një ëndrre të singërtë.

Një projekt nga Agjencia Zvicerane për
Zhvillim dhe Bashkëpunim SDC

Në partneritet me:

Zbatuar nga:



Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Agjencia Zvicerane për Zhvillim
dhe Bashkëpunim SDC



HELVETAS



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Por nuk ishte fundi, përkundrazi. Ishte fillimi i një rruge të re. Pikërisht në zyrën e këshillimit të karrierës, u arrit një zbulim që do ta ndihmonte të rishikonte rrugët e mundshme. *“Më treguan se aftësitë e mia si inxhinier elektronik janë të vlefshme edhe jashtë fushës klasike në IT, automatizim, mirëmbajtje teknike, madje edhe në edukim”.* Ky moment, sipas tij, ishte vendimtar. I dha sigurinë që nuk kishte dalë jashtë rruge, por thjesht po ndjek një shteg më të gjerë.

Jo çdo mundësi e sugjeruar ishte e mirëpritur. *“Menjëherë përjashtova profesionin e shitësit apo marketingut”,* shpjegon ai. *“Nuk më përshtatet puna me klientë, ndihem më rahat me sisteme teknike dhe zgjidhje konkrete.”*

A ndryshoi këndvështrimi i tij për të ardhmen? *“Shumë. Më parë e shihja veten domosdoshmërisht në një kompani elektronike. Tani jam më fleksibël, e imagjinoj veten në një rol teknik, ku mund të përfshij edhe trajnimin ose zbatimin e teknologjisë në fusha të ndryshme”.*

Si shumë të rinj, edhe ai përjetoi një moment paqartësie pas diplomimit. *“Kisha shumë teori, por pak mundësi konkrete. Ishte një periudhë kur ndihesha i humbur”.* Po ashtu, e ka ndjerë disa herë sikur sistemi arsimor dhe tregu i punës nuk flasin të njëjtën gjuhë. *“Përgatitesh për diçka që nuk ka kërkesë në realitet. Kjo të shtyn drejt rrugëve që nuk i kishe menduar kurrë.”*

Por gjatë këshillimit, një fushë e re i tërhoqi vëmendjen: automatizimi industrial dhe programimi i sistemeve të kontrollit. *“As që e kisha konsideruar më parë, por mësova se është një nga fushat më të kërkuara dhe përputhet shumë me formimin tim.”*

Sot, Fleanci ka një mesazhi: *“Mëso teknologji praktike që herët, mos u mjafto vetëm me teori. Eksploro fusha të ndryshme dhe mëso programim.”*

Prindërit e tij e kanë mbështetur gjithmonë, ndonëse nuk kishin informacion të mjaftueshëm për tregun e teknologjisë. Ndërsa miqtë kanë qenë një ndihmë e madhe, duke ndarë përvoja të ndryshme që i kanë hapur horizonte të reja.

A ka ende dyshime për rrugën që ka zgjedhur? *“Sigurisht që po. Realiteti ndryshon vazhdimisht. Por falë këshillimit, tani kam më shumë informacion dhe qartësi për mundësitë që kam në dorë.”*

